

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva : Arhiva - Archive

Nr. i Prot. 1098-39/2023
Org. i Prot. 02/2023
Nr. i llogave 12-7
Broj stranice 25.07.2023
Dafite PRISHTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Drenasit	
	Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 21.07.2023 Referencë: 164/2023
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Bora Duli, Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Drenasit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimin 02 Nr.400/01-31029/23, për miratimin e Kërkesës Nr. 01-070/01-28069, dt. 13.06.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – OU Nicrophthalma;</i>
<i>Vendimin 02 Nr.400/01-31027/23, për miratimin e Kërkesës Nr. 01-070/01-26071, dt. 01.06.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer; dhe</i>
<i>Vendimin 02 Nr.400/01-31026/23, për financimin e projektit “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”</i>
<i>Të miratuara më datë 29.06.2023</i>
<i>Të parashtruara për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 30.06.2023</i>
<i>Të dërguara për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 03.07.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të mësipërme të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të akteve administrative që janë subjekt i shqyrtimit, synon ndarjen e mjeteve financiare për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes për qytetarë, dhe për financimin e projektit “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”.
2. Edhe përkundër faktit se Komunave iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuara me nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitat obligohen t’i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si “LMFPP”) dhe Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7 Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFP-së gjatë disponimit me këto burime financiare.

3. Ajo që i faktorizon edhe më shumë detyrimet e përcaktuara me dispozitat e LMFP-së është neni 81 i LMFP-së, në të cilin precizohet që në rastet kur ky ligj ka mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, dispozitat e LMFP-së kanë përparësi, sikurse përshkruhet më poshtë:

Neni 81

Hyrja në fuqi/Shfuqizimi i legjislacionit paraprak/Zbatueshmëria

81.1. Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike, dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të kenë përparësi, në pajtim edhe me nenin 36 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. [theks i shtuar]

4. Në rrjedhë të kësaj, LMFP konsiderohet ligj organik që përcakton kushtet, procedurat dhe konditat ligjore për menaxhimin e mirëfilltë të financave publike në përgjithësi, dhe shpenzimin e parasë publike në veçanti.
5. Në kuptim të shpenzimit të rregullt të parasë publike, neni 17 i LMFP-së precizon qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga fondet e ndara dhe të alokuara [theks i shtuar].
6. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Drenasit, ku është evidentuar se organizata buxhetore i ka të planifikuara shpenzimet e potencuara me aktin komunal për këtë vit fiskal.
7. Si përfundim, dhe duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, aktet administrative të Komunës së Drenasit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi pasi që ka mjete në dispozicion për zbatimin e vendimeve.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas (Glllogocit)
Kuvendi Komunal



02 Nr. 400/01-3026 dt. 29/06/2023

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, pika 40.2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr. 320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullores MF-NR 04/2017 mbi Kritret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, vendimit 01 Nr.400/01-2789, të dt. 12.06.2023, si dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.06.2023 miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1

Me këtë vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar”, të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2023.

Neni 2

Projekti i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”- “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar”, përkrahet në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2023.

Neni 3

Financimi- Subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike e shpenzimeve subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të parapara me Buxhetin për vitin 2023 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Presonave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimvendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “HANDIKOS”, që të bëjë raport narrativ-me shkrim dhe financiar përmes zyrtarit monitorues në mënyrë që të njoftojë DSHMS-në për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

Neni 5

Për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Arsyetimi

Bazuar në nenin 16 paragrafi 3, të Rregullorës MF-NR. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Nr. 12/320-19338, të dt. 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, është formuar komisioni me Vendimin Nr. 01-020/04-24052 e dt. 22.05.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr.06-400/01-22083, të dt. 10.05.2023, të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2023.

Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e aplikantëve për subvencionim të OJQ-ve në bazë të thirrjes publike të lartëcekur, ku gjithsej kishin aplikuar dy (dy) OJQ: “HANDIKOS” dhe “BLIRI” .

Pas hapjes së zarfeve të OJQ-ve aplikuese, komisioni ka verifikuar dokumentacionet e dorëzuara të dy organizatave aplikuese, të cilat vazhdojnë të jenë funksionale, mirëpo OJQ “Bliri” nuk i ka përmbushur kriteret e thirrjes publike dhe si rrjedhojë komisioni me vendim përcakton si aplikant i kualifikuar për mbështetje financiare Shoqatën e Përsoneve me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS” Drenas.

Meqë vlera e përkrahjes financiare në bazë të thirrjes publike është 5.000 €, kjo shumë do t'i ndahet kësaj OJQ-je, financimi- subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të paraparë me Buxhetin për vitin 2023 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.